



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

# **DETYRË PROJEKTIMI PERFUNDIMTARE**

**PËR**

**HARTIMI PROJEKTIT TE ZBATIMIT PËR OBJEKTIN**

**“RINDERTIMI NE TRUALLIN EKZISTUES TE DY NJESIVE  
TE BANIMIT (PALLAT), PALLATI NR.3 DHE NR.4 NE  
BASHKINE KURBIN, NË KUADËR TË PROCESIT TË  
RINDËRTIMIT”**

**Kurbin, 2022**

Në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si dhe **VENDIM Nr. 502, datë 27.7.2022 PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), BASHKIA KURBIN, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE**

**Synimi dhe Objektivat:**

Synimi i këtij investimi është ndërtimi i dy banesave kolektive të miratuara si pjesë e programit të rindërtimit në zonat e prekura nga tërmeti në përputhje me standartet më të larta të mundshme, duke patur si objektiv, hartimin e projektit të zbatimit bazuar në detyrat e projektimit për secilin objekt, marrjen e miratimeve dhe nxjerrjen e lejeve përkatëse, realizimi i punimeve të ndërtimit dhe dorëzimi i objekteve të përfundura .

Bashkia Kurbin në kuadër të procesit të rindërtimit do të vijojë me procedurat e ndërtimeve të objekteve të dëmtuara dhe konkretisht për objektin: **“Rindërtimi në Truallin Ekzistues Te Dy Njesive Te Banimit (Pallat), Pallati Nr.3 dhe nr.4 në Bashkinë Kurbin, Në Kuadër Të Procesit Të Rindërtimit”**

**Të dhëna të përgjithshme dhe gjendja ekzistuese e objektit**

**Vendndodhja:**

1. Objekt ekzistues pallat nr.3, (5 kate), pallati nr.142 i ndodhur në Zona kadastrale 2364 Njësi Administrative Laç, Bashkia Kurbin, prishje dhe rindërtim në truallin ekzistues.
2. Objekt ekzistues pallat nr.4,( 5 kate), pallati nr.143 i ndodhur në Zona Kadastrale 2364, Njësia Administrative Lac, Bashkia Kurbin, prishje dhe rindërtim në truallin ekzistues

Figura 1 Planvendosja e banesës kolektive(pallat), në zonën kadastrale 2364, nr. Pasurie, Njësia Administrative Lac



Zona në fjalë ka një Vendim keshilli Bashkiak të miratuar me numër vendimi 84, datë 20.10.2022 e numër protokoli 5426/1, datë 20.10.2022.

Banesat ndodhen pranë njëra tjetrës. Janë të pozicionuara në një ne Lagjen nr.3 Njësinë Administrative Laç. Këto janë parashikuar të ndërtohen banesa kolektive (pallat) për banorët e prekur nga tërmeti i datës 26.09.2020, të cilëve, banesat u janë shpallur të pabanueshme nga ekspertizat. Dhe janë shpallur për shembje nga opionencat teknike të hartuara nga instituti i ndertimit.

- Objektet , duhet të rindërtohen duke plotësuar normativat dhe kushtet në fuqi bazuar në numrin e banorve, dhe në kërkesat e zyrës së rindertimit për akomodim, në Njësinë Administrative Lac.

## **2. Kërkesa projektimi të përgjithshme**

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri duke u bazuar tek Eurokodet. Projektuesi do të përdorë standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga Qeveria Shqiptare sipas legjislacioni në fuqi.

## **3. Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale**

## **Themelet**

Për ndërtimin e një objekti të ri është e domosdoshme përcaktimi i vetive fizike dhe mekanike të dherave dhe masave gjeologjike me ane të një studimi gjeologjik të terrenit të përcaktuar ku parashikohet të ngrihen tre banesat kolektive (pallat). Projektimi dhe zbatimi të bëhen në bazë të legjislacionit në fuqi dhe Eurokodit.

## **Konstruksioni b/a dhe muratura**

Ndërtimi i konstruksionit mbajtës do të jetë prej skeleti betoni dhe ndërtime murature brenda, të kombinuara me struktura sizmike për projektimet strukturore, me soleta betoni. Është detyrë e konsulentit të zbatojë Kushtet Teknike të Projektimit shqiptar bazuar në legjislacionin në fuqi, specifike për objektin në fjalë, si dhe standartet e miratuara, lidhur me materialet që do të përdoren dhe efikasitetin e energjisë, Vkm 319 date 12.04.2017. Të bëhet kafazi i ashensorit.

## **Mbulesa e objektit**

Mbulesa të bëhet me cati me tjegulla të cilësisë së parë. Catia të ketë shtresat për hidro izolimin si dhe për nxehtësinë. Projektuesi duhet të japë të gjitha detajet për shtresat e vendosjen e kasetës së shkarkimit dhe ullukëve vertikalë - horizontalë. Ullukët të jenë me material bakri. Në projektimin e ullukëve duhet të merret në konsideratë që të mos bllokohen nga faktorët e jashtëm. Në cati duhet të evidentohen problematikat e filtrimit të ujërave dhe izolimit dhe të parashikohet aftësia e saj mbajtëse.

## **Suvatimet dhe lyerja e mureve**

Objekti duhet të suvatohet nga brenda dhe nga jashtë. Muret dhe tavanet do të lyhen me bojë hidromat, ndërsa ngjyra e tyre do të vendoset në bashkëpunim me banorët. Korridorët do të lyhen me bojë hidroplastike që të mund të pastrohen lehtësisht.

## **Fasada**

Fasada të jetë e tillë, që të mirëmbahet lehtë, duhet të vishet me sistem kapot me Polisterol. Veshje me polisterol deri në 5cm me ngjitje me kolle dhe upa plastike 5 cope/1m<sup>2</sup> dhe suvatim me grafiato akrilike. Xokolatura të trajtohet për lagështinë dhe të ketë lartësinë mbi 80 cm.

## **Shtresat e pllakave dhe veshjet**

Të shtrohet dyshemeja me pllaka shtrim dhe veshje gres-porcelanat me permasa deri në 60x60cm. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse. Shkallët të vishen me granit me korimano alumini. Shtresa e dhomave të gjumit të bëhet me parket laminat C/10. Shtrimi i korridorit të pallatit të bëhet me granit me pllake dhe hyrja kryesore të trajtohet nga ana vizuale dhe arkitektonike. Fasada e ashensorit të vishet me granit si shkallët.

## **Dyert dhe dritaret**

Projektuesi duhet të përcaktojë me detaje vendosjen e dyerve dhe dritareve. Të vendoset mermer te dritaret dhe tek hyrjet e banesave. Dyert e jashtme duhet të parashikohen të blinduara, sipas standardeve në fuqi, dyert e brendshme me material antizjarr dhe druri, sipas projektit dhe specifikimeve të projektit MNZ. Dritare të përzgjidhen të tilla që të sigurojnë efikasitet termike, plastike, të vendosen rrjeta dhe grila në mure.

## **Ambientet sanitare**

Tualetet duhet të parashikohen me ajrosje natyrore. Të parashikohet hidroizolimi i tyre, shtrimi dhe veshja me pllaka, instalimi i të gjitha pajisjeve H/S, WC, bide, lavaman, furnizimi me ujë të ngrohtë i cili do të bëhet me boiler individual. Do të bëhet furnizimi me pajisjet hidrosanitare në çdo njësi hidrosanitare.

## **Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve**

Gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të merren parasysh kërkesat si më poshtë:

1. Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonës ku do të ndërtohet, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve dhe furnizimit me ujë për këto zona.
2. Drejtimi i zhvillimit urbanistik i zonës do të merret në Bashki.

Për orientim, sasi të ujërave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve të qytetit të Kurbin të përdorura për projektimin e rrjetit të kanalizimeve. Linja e jashtme të shoqërohet me puseta kontrolli në dalje të objektit.

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e banorëve, stafit administrativ.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkohore dhe në përputhje me standartet në fuqi.

Materiale plastike nuk do të përdoren në projekt si: kanal kullimi, ulluk shiu, tubacion, pjesët e brendshme të WC-ve, etj, përveç se në rastet kur rekomandohet nga konsulenti se është materiali më i mirë që mund të përdoret për këtë qëllim. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujësjellës-Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjëndja e ujësjellësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Materialet që do të përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi

dhe riparimi. Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë dhe kanalizime nga pika e marrjes dhe e derdhjes së dhënë nga Ujësjetës –Kanalizime sh.a Kurbin deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, për nevojat MKZ dhe hidrosanitare. Të pajisen me pompa për furnizimin me ujë të mjaftueshëm dhe të pandërprerë në bashkupim me ndërmarjen e Ujësjetës Kanalizimit Kurbin.

### **Sistemi elektrik i rrjeti i fuqisë, ndriçimit, i emergjencës dhe sigurisë**

Konsulenti duhet të parashikojë instalimet përkatëse për ndriçimin e ambienteve të banesave me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik të objektit që të sigurojë funksionim normal të sistemit, referuar me pajisjet që do të përdoren.

I gjithë sistemi elektrik duhet të jetë i tillë që të stakohet në një pikë të vetme në katin e parë, e cila mund të arrihet lehtë dhe të ketë shenjat dalluese përkatëse. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqisë duhet të jetë e afishuar në panelin e stakimit. Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni.

Të paraqitet në plane dhe detaje tokëzimi i kuadrit elektrik. Të merret parasysh ndërtimi i kabinave për cdo pallat si dhe transformatorët përkatës.

### **Sistemi i mbrojtjes atmosferike**

Godinat duhet patjetër të kenë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjëndet në një zonë me shkarkime atmosferike të shumta.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit. Të detajohet projekti i rrufe pritësit dhe të integrohet në projektet e tjera.

### **Sistemi i mbrojtjes nga zjarri (MNZ)**

Konsulenti duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standarteve europiane si dhe duhet të paraqesë aksesin e zjarrfikëses në godinë. Në koridoret e banesave kolektive të vendosen hidrantet.

### **Sistemi i lajmërimit për zjarrin**

Në objekt të shikohet mundësia që të ketë gjithashtu sistemin e brendshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtësa. Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jetë i qartë e i kuptueshëm nga të gjithë. Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

### **Bombulat fikëse të zjarrit**

Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në korridore dhe në ambientin teknik.

## **Shkallët e emergjencës.**

Konsulenti duhet të parashikojë edhe shkallët e emergjencës sipas standardeve në fuqi. Ato duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik.

## **Ambienti teknik.**

Konsulenti duhet të parashikojë ambientin teknik në katin nëntokë për instalimin e sistemit të pompave, elektromotopompë dhe rezervuarët të ujit dhe numrit të tyre të llogaritur në varësi të numrit të banoreve në këtë objekt si dhe montim i impjantit qëndror të depozitimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm të objektit sipas specifikimeve të projektuesit.

## **Sistemi i Kondicionimit**

Konsulenti duhet të parashikojë instalimin e linajve të sistemit të kondicionimit dhe aspirimit. Sistemi duhet të parashikohet sistem me ngrohje ftohje, për çdo njësi individuale dhe të ndërtohet skema principale gjithashtu të bëhet.

## **Muret ndarëse të brendshme**

Muret e brendshme të specifikuar sipas projektuesit, ku të jenë të parashikuara shtresat e nevojshme si dhe shtresa zëizoluese për mos depërtimin e zhurmave nga njëri ambient në tjetrin. Ndarjet të bëhen me mur tulle me polisterol.

## **Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara**

Projektuesi duhet t'i kushtojë një rëndësi e veçantë sistemimit të ambientit përreth. Ambientet e jashtme, janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje, sidomos si ambiente loje për fëmijët. Rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta me pemë si dhe ndricimi i jashtëm LED dhe fotovoltaike. Për të mbajtur pastërtinë duhet të vendosen kosha për mbeturinat në oborr. T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemimit dhe disiplinimit të ujrave sipërfaqësore. Ambienti të jetë i ndricuar dhe me ambiente çlodhese.

Për secilin nga pallatet të krijohet infrastruktura rrugore, trotuaret, ambientet çlodhese dhe argetuese. Të llogaritet në ambientin e jashtëm mundësia e një parkimi për rezidentët e pallatit.

Ambienti duhet të ketë akses nga të gjitha anët për persona të kufizuar.

## 4 . Kërkesa të veçanta

Ne realizimin e projektit të ndërtimit si dhe atij të mirëfillte arkitektonik duhen patur parasysh dhe te gjejnë zbatimin e duhur te gjitha rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar PAK. Projektuesi duhet të parashikojë në projekt/preventiv edhe rampat për lëvizjet e personave më aftësi të kufizuar (PAK).

## 5. Fazat e realizimit të projektit

Projekti për objektin: **“Rindertimi ne Truallin Ekzistues Te Dy Njesive Te Banimit (Pallat), Pallati Nr.3 dhe nr.4 ne Bashkine Kurbin, Në Kuadër Të Procesit Të Rindërtimit”**

duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim”, duhet të kalojë në këto faza:

### **FAZA 1 Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit)**

**Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, ku per te cilen do të dorëzohen:**

- a. Vizatimet teknike (planimetri e përgjithshme, planvendosja, projekti Mnz, elektrik, hidro, ngrohje ,te pakten 4 imazhe render te jashtme, 2 imazhe render te hapësirave te brendshme etj.);
- b. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara)
- c. Preventiv paraprak;

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet Bashkia Kurbin, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare. (Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

***Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,Ëord etj.)***

### **FAZA 2: Projekti zbatimi: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.**

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin: **“Rindertimi ne Truallin Ekzistues Te Dy Njesive Te Banimit (Pallat), Pallati Nr.3 dhe nr.4 ne Bashkine Kurbin, Në Kuadër Të Procesit Të Rindërtimit”**

**ne kuader te procesit te rindertimit.** do përmbajë:



- Raport gjeologjik
- Raport Sizmik
- Raportet teknike me llogaritjet perkatese (sizmik, konstruktiv, arkitektonik, topografik, furnizimi me uje, elektrik, kondicionimi, eficenca energjitike, kush/kuz,)
- Planvendosjen e objektit
- Planimetritë e pergjitheshme dhe te kateve
- Rilevimin topografik
- Projektin arkitektonik
- Projektin konstruktiv
- Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin
- Projekti hidroteknik
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza;
- Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit;
- Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
- Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;
- Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikon e punimeve;
- Plan sistemimi
- Oponence teknike
- Detaje sistemimi te jashtem, infratrutkure rrugore dhe çlodhese
- Projekt elektrik
- Projekt I sistemit te Ngrohjes dhe Ventilimit
- Vleresimi I Ndikimit ne Mjedis

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dëg., ëord, excel., pdf

### **FAZA 3: Hartimi i preventivit përfundimtar**

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit (ndertim montim), që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ ofertat përkatëse të çmimeve., të cilat do ti bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/ modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Kurbin.

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme.

## **6. Rekomandime per projektuesin**

### ***Standarde në Projektim***

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori. Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Kjo llogaritje është bere paraprakisht, llogaritja është parashikuar ne vlere maksimale. Pas hartimit te projektit, dhe llogaritjes se sakte sipas kerkeses per rindertim, te behet preventivi i sakte dhe i detajuar, sipas kushteve teknike te projektimit. Diferenca e mbetur t'i rialokohet buxhetit te shtetit, per vitin pasardhes.

### **Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

**Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.**

## **7. Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar**

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Kurbin. Stafi që kërkohet duhet të mbulojë :

1. *Arkitekt*
2. *Inxhinier hidroteknik/ hidraulik*
3. *Inxhinier elektrik*
4. *Inxhinier mekanik*
5. *Inxhinier konstruktiv*
6. *Inxhinier topograf*
7. *Preventivues*
8. *Inxhinier mjedisi*
9. *Staf mbështetës për fushat e mësipërme*

## 8. Paraqitja e vizatimeve.

Vizatimet duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. Planvendosjen e objektit në Shk 1:100
2. Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
3. Fasadat në 2D dhe 3D Shk.1:100
4. Detaje te veshjeve te fasadave, te pllakave te sistemimit te tarraces, Shk.1:50
5. Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
6. Planin e tarrace ose catise Shk.1:100
7. Planimetria e themeleve Shk.1:100
8. Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
9. Detaje te kolonave dhe soletave Shk.1:20; 1:10
10. Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
11. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
12. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
13. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
14. Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100
15. Planimetria dhe detaje të sistemit te mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
16. Planimetri dhe detajet për instalimin e dyerëve dhe e dritareve Shk.1:100; 1:50
17. Planimetri dhe detaje për furnizimin me energji elektrike, fiksimin e ndriçuesve në tavan për ambientet e përbashkëta, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50
18. Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objekti, Shk. 1:100
19. Planimetria e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike Shk. 1:100
20. Planimetria e tokezimit te kuadrit elektrik, Shk. 1:100
21. Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
22. Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
23. Planimetria e ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50
24. Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.
25. Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3;
26. Vizatimet dhe detajet përkatëse për shkallët e emergjencës Shk.1:100; 1:50
27. Plan organizim
28. Plansistemim + prerje gjatesore
29. Plan rilevim topografik me kuota
30. Detaje sistemimi te jashtem, infratrutkure rrugore dhe çlodhese Shk.1:100; 1:50

### Relacionet shoqeruese

1. Raport elektrik
2. Specifikime teknike per çdo sistem te nevojshem
3. Raport hidro, kush, kuz
4. Raport konstruktiv+ llogaritjet e struktures
5. Raport i sistemeve mekanike, ngrohje – ftohje, mnz. Etj..
6. Raport arkitektonik
7. Raport teknik
8. Raport mbi efiçencen e energjise

9. *Raport VNM*
10. *Preventiv*
11. *Raporti topografik*
12. *Grafiku i punimeve*
13. *Licensat e stafit projektues*
14. *Raport MNZ*
15. *Raport gjeologjik*
16. *Raport Sizmik*
17. *Police sigurimi per secilin projektues*
18. *Deklaratat e Pergjjesise Profesionale te Projektuesve*

*Në fletët e vizatimit të konstruksionit të objektit duhet të jepen dhe tabelat e specifikimit për çdo material, hekur, beton, tulla etj.*

### **9. Raportimi dhe dorëzimi final**

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 3 (tre) kopje me ngjyra , në gjuhën shqipe. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg” (AutoCad 2007-2012). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 8 CD).

### **10. Investimi Themelor**

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mirë tekniko- ekonomik i aprovuar Bashkia Kurbin.

**Pergatiti D.P.K.ZH.T**